


PETICIONI “PËR FERIZAJN PA UROŠEVAC”



**IMPLIKIMET JURIDIKE DHE POLITIKE
PËR PËRDORIMIN ZYRTAR TË GJUHËVE
DHE MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË
KOMUNITETEVE NË KOSOVË**



Për botuesin: OJQ AKTIV
Adresa: Kralja Petra 183a,
Mitrovicë e Veriut
Email: info@ngoaktiv.org
Ueb-faqja: www.ngoaktiv.org
Mitrovicë, 2026.

Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e OJQ Aktiv dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së, apo Suedisë.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Hyrje

Nisja e nismës qytetare “Për Ferizajn pa Uroševac”¹, përmes së cilës i kërkohet Kuvendit të Kosovës heqja nga përdorimi zyrtar i emërimit serb “Uroševac” dhe përdorimi vetëm i emërimit “Ferizaj” në komunikimin zyrtar të institucioneve, përbën një çështje që tejkalon kufijtë e politikës lokale dhe të rregullimit administrativ të emërimit të një qyteti.

Mbështetja që kjo nismë ka marrë nga kryetari i Komunës së Ferizajt Agim Aliu² si dhe nga përfaqësuesit e disa subjekteve politike në komunë, tregon se nuk bëhet fjalë për një kërkesë të izoluar qytetare, por për një nismë që mund të ketë pasoja më të gjera institucionale.

Megjithëse organizatorët deklarojnë se qëllimi i peticionit nuk është i drejtuar kundër asnjë komuniteti³, por se synon “korrigjimin e një padrejtësie historike”, objekti i tij lidhet drejtpërdrejt me një nga elementet themelore të rendit kushtetues të Kosovës – përdorimin e barabartë zyrtar të gjuhës shqipe dhe asaj serbe. Rrjedhimisht, kjo çështje tejkalon kontekstin politik lokal dhe shndërrohet në çështje të respektimit të garancive kushtetuese, detyrimeve ndërkombëtare dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve joshumicë.

¹ https://www.dropbox.com/scl/fi/a7chf4ke33113opnsm7gb/Pet-icioniPernjeFerizajPaUroševac.pdf?rlkey=8iytr7m8j27rgxw29n9j870u2&st=s-Qj7cbph&fbclid=IwY2xjawTK8HpleHRuA2Fl-bQlxMABicmIkETfMmRUdIb2ZZQTQzN0tv-cE9Sc3J0YwZhcHBfaWQQMjlyMDM5MT-c4ODlwMDg5MgABHsYeKZ5pmQINtsFa-VzTq3sj1fGptUfsUQbIU_ehpgcBWWCBqY-77p1LiIvCDs_aem_4uMSufEYT_yEgo5Ti-wsq5Q&e=1&dl=0

² <https://www.facebook.com/share/p/1bWi-JNur1K/>

³ <https://www.koha.net/arberi/ferizaj-kerkon-heqjen-e-emrit-uroševac-nga-perdorimi-zyrtar-nisin-nenshkrimet>

Korniza ligjore

Kosova ka një nga kornizat normative më gjithëpërfshirëse në rajon për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshumicë. Shumica e këtyre garancive burojnë nga Plani i Ahtisaarit⁴, dhe përbën bazën e sistemit të tanishëm institucional. Neni 5 i Kushtetutës përcakton se gjuha shqipe dhe gjuha serbe janë gjuhë zyrtare dhe, rrjedhimisht, kanë status të barabartë para të gjitha organeve. Kjo do të thotë se të dyja gjuhët duhet të përdoren në ligje, akte nënligjore, dokumente zyrtare, regjistra, mbishkrime publike, komunikimin e institucioneve dhe forma të tjera të përdorimit zyrtar.

Përveç barazisë së përgjithshme të gjuhëve, Kushtetuta u ofron mbrojtje shtesë komuniteteve joshumicë. Neni 57 garanton mbrojtjen, përkatësisht zhvillimin e identitetit të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Neni 58 e obligon Kosovën të sigurojë kushtet e nevojshme që komunitetet të mund ta “ruajnë, mbrojnë dhe zhvillojnë” identitetin e tyre, si dhe të “promovojë frymën e tolerancës dhe të dialogut dhe të mbështesë pajtimin ndërmjet komuniteteve”.

Për nismën në fjalë, rëndësi të veçantë ka neni 59, i cili u garanton komuniteteve të drejta të veçanta, përfshirë të drejtën për ruajtjen e identitetit kombëtar, kulturor dhe gjuhësor; të drejtën për përdorimin e lirë të gjuhës dhe alfabetit të tyre; si dhe të drejtën për përdorimin e emërtimeve lokale dhe emërtimeve të rrugëve që pasqyrojnë karakterin shumëgjuhësh të Kosovës. Nga të gjitha këto dispozita rrjedh se emërtimi zyrtar i një qyteti nuk është vetëm kategori administrative, por pjesë e sistemit të mbrojtjes së të drejtave gjuhësore të garantuara me Kushtetutë.

Korniza ligjore që rregullon përdorimin zyrtar të gjuhëve në Kosovë është përcaktuar në nivel kushtetues dhe parashikon mekanizma të posaçëm mbrojtës, të cilët pengojnë ndryshimin e saj përmes vendimeve të zakonshme politike ose administrative. Ndryshimi i dispozitave kushtetuese që rregullojnë të drejtat e komuniteteve dhe përdorimin e gjuhëve zyrtare kërkon shumicën prej dy të tretash të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, si dhe shumicën prej dy të tretash të deputetëve që përfaqësojnë komunitetet joshumicë⁵.

Këto dispozita kushtetuese shtjellohen më tej në Ligjin për përdorimin e gjuhëve⁷, i cili përcakton se të gjitha institucionet, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, janë të obliguara të sigurojnë përdorimin e barabartë të të dyja gjuhëve zyrtare. Kjo nënkupton që të gjitha dokumentet zyrtare duhet të jenë të disponueshme në të dyja gjuhët; regjistrat publikë duhet t'i përdorin të dyja gjuhët; ndërsa emërtimet e institucioneve, rrugëve, vendbanimeve dhe komunave përbëjnë pjesë të përdorimit zyrtar të gjuhëve.

Ligji për vetëqeverisjen lokale⁸ u garanton komunave një shkallë të gjerë autonomie në ushtrimin e përgjegjësiive lokale, por njëkohësisht përcakton qartë se ato janë të obliguara të veprojnë

⁴ <https://digitallibrary.un.org/record/595359>

⁵ <https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2020/07/Ustav-Republike-Kosova.pdf>

⁶ Constitution of the Republic of Kosovo, Article 144 (Amendment), <https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2020/07/Ustav-Republike-Kosova.pdf>

⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx>

⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530&langid=2&utm>

në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Kjo do të thotë se pushteti komunal nuk mund të marrë vendime që do të ndryshonin garancitë kushtetuese ose do të kufizonin të drejtat që burojnë nga statusi zyrtar i gjuhës serbe.

Nëse statusi i njërit prej emërtimeve zyrtare do të mund të hiqej përmes një nisme politike, do të shtrohej pyetja nëse i njëjti parim mund të zbatohet edhe ndaj komunave dhe vendbanimeve të tjera që kanë emërtime zyrtare në gjuhën serbe. Në këtë mënyrë do të hapej rruga për vënien gradualisht në pikëpyetje të njërit prej elementeve kryesore të sistemit të mbrojtjes së komuniteteve, të krijuar pas vitit 2008.

Pranimi i mundshëm i një qasjeje të tillë mund të kishte edhe pasoja më të gjera institucionale. Nëse kundërshtimi i emërtimeve zyrtare të bazuara në përdorimin e barabartë të gjuhëve do të pranohej si praktikë legjitime politike, kërkesa të ngjashme mund të shtriheshin edhe ndaj elementeve të tjera të përdorimit zyrtar të gjuhës serbe, duke përfshirë emërtimet e institucioneve publike, regjistrat zyrtarë, sinjalistikën publike, evidencat kadas-trale, dokumentet personale dhe aktet e tjera në të cilat aktualisht zbatohet detyrimi kushtetues për dygjuhësi. Në këtë mënyrë do të krijohet hapësirë për vënien graduale në pikëpyetje të aspekteve të veçanta të sistemit të mbrojtjes së të drejtave gjuhësore, në vend të zbatimit të tyre konsekuent.

Në këtë kuptim, nisma për heqjen nga përdorimi zyrtar të emërtimit "Uroševac" nuk përbën vetëm një debat lokal rreth një toponimi, por ngre çështjen e zbatimit konsekuent të parimeve mbi të cilat mbështetet i gjithë sistemi kushtetues për mbrojtjen e komuniteteve në Kosovë.

Sfidat sistematike në realizimin e të drejtave gjuhësore

Çështja e ngritur nga nisma për heqjen nga përdorimi zyrtar të emërimit “Uroševac” nuk mund të trajtohet në mënyrë të izoluar. Ajo ndërlidhet me sfidat shumëvjeçare në realizimin e të drejtave gjuhësore në Kosovë.

Raportet e Misionit të OSBE-së⁹, Këshillit të Evropës, Bashkimit Evropian, mediave dhe shoqërisë civile, përfshirë edhe OJQ Aktiv¹⁰ prej vitesh vënë në dukje zbatimin jokonsekuent të detyrimeve ligjore, duke përfshirë problemet me cilësinë dhe ofrimin në kohë të përkthimeve të dokumenteve zyrtare, zbatimin e pabarabartë të dygjuhësisë dhe sfida të tjera në realizimin e të drejtave gjuhësore.

Në këtë kontekst, nisma për heqjen e emërimit zyrtar serb të një qyteti mund të shihet si pjesë e një modeli më të gjerë, në të cilin niveli i arritur i mbrojtjes së të drejtave gjuhësore nuk përparon, por vihet në pikëpyetje.

⁹ <https://omik.osce.org/mission-in-kosovo/396836>

¹⁰ <https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2025/12/MONITORING-SPRO-VODENJA-ZAKONA-U-INSTITUCIJAMA-2025-111-1.pdf>

Përgjegjësia institucionale dhe mungesa e reagimit

Zyra e Komisionerit për Gjuhët¹¹ është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, shqyrtimin e ankesave të personave fizikë dhe juridikë, zhvillimin e hetimeve në bazë të ankesave dhe me nismën e vet (ex officio), dhënien e rekomandimeve për institucionet kompetente dhe ndërmarrjen e masave për të siguruar përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare.

Në këtë kuptim, roli i saj përbën një nga mekanizmat kryesorë institucionalë për ruajtjen e sistemit kushtetues dhe ligjor të mbrojtjes së të drejtave gjuhësore në Kosovë. Megjithatë, kjo zyrë prej një kohe të gjatë funksionon pa një komisioner të emëruar për gjuhët. Në Raportin Vjetor për vitin 2025¹² Institucioni i Avokatit të Popullit e vlerësoi këtë si një rrethanë që rrezikon seriozisht mbikëqyrjen institucionale të zbatimit të legjislacionit në fushën e të drejtave gjuhësore.

Njëkohësisht, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është përgjegjëse për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së komunave, përfshirë çështjet që lidhen me zbatimin e ligjeve dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve.

Mungesa e reagimit nga institucionet kompetente, para së gjithash nga Qeveria e Kosovës dhe ministria përkatëse, por edhe nga aktorë të tjerë institucionalë dhe politikë, përfshirë përfaqësuesit e Listës Serbe, si dhe reagimi i kufizuar apo mungesa e plotë e reagimit nga organizatat ndërkombëtare që mbikëqyrin zbatimin e standardeve në fushën e sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve, lënë të hapura pikëpyetje lidhur me efektivitetin e mekanizmave ekzistues të mbrojtjes.

Në rrethana kur besimi i një pjese të konsiderueshme të qytetarëve në institucione tashmë është cenuar seriozisht, një qasje e tillë e vështirëson edhe më tej rikthimin e tij dhe përcjell mesazhin se zbatimi konsekuent i garancive kushtetuese dhe ligjore mund të varet nga konteksti politik, e jo nga parimet e sundimit të ligjit.

¹¹ <https://kryeministri.rks-gov.net/en/office-of-the-language-commissioner/>

¹² https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2026/03/Annual-Report-2025_compressed.pdf

Pasojat për marrëdhëniet ndëretnike dhe procesin e normalizimit

Krahas aspektit juridik, kjo nismë mbart edhe pasoja të rëndësishme politike.

Që nga fillimi i dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, një nga synimet themelore të procesit të normalizimit ka qenë ndërtimi i besimit ndërmjet komuniteteve dhe krijimi i një mjedisi institucional në të cilin të drejtat e të gjithë qytetarëve mbrohen në mënyrë të barabartë.

Pikërisht për këtë arsye, çdo nismë që mund të perceptohet si ulje e nivelit të arritur të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve ka potencial të ndikojë negativisht në besimin e ndërsjellë, ta vështirësojë më tej dialogun politik dhe të kontribuojë në zbatimin selektiv të sundimit të ligjit.

Regjistrimi i popullsisë dhe mbrojtja e të drejtave kolektive

Pas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, i cili nuk i përfshiu katër komunat në veri të Kosovës për shkak të bojkotit nga popullsia shumicë serbe, organizatat ndërkombëtare, përfshirë OSBE-në, në analizat e tyre përdorën vlerësime sipas të cilave në Kosovë jetonin afërsisht 146.000 serbë, ose rreth 7,8% e popullsisë.¹³ Një çështje e ngjashme u ngrit edhe pas regjistrimit të popullsisë të vitit 2024, megjithëse rrethanat ishin të ndryshme. Ndryshe nga viti 2011, regjistrimi u zhvillua formalisht edhe në veri të Kosovës, por mbulimi i tij ishte i kufizuar si pasojë e ndërthurjes së disa faktorëve. Nga njëra anë, Lista Serbe u bëri thirrje publike qytetarëve që ta bojkotonin pjesërisht regjistrimin në katër komunat veriore, gjë që ndikoi në pjesëmarrjen e një pjese të popullsisë. Nga ana tjetër, shumë qytetarë dhe përfaqësues të komunitetit lokal vunë në dukje numrin e pamjaftueshëm të regjistruarve të angazhuar dhe qasjen e kufizuar të ekipet e regjistrimit, duke pretenduar se disa qytetarë të interesuar nuk patën mundësi të regjistroheshin gjatë periudhës së parashikuar.

Gjatë procesit të rregullt të regjistrimit u regjistruan 36.652 pjesëtarë të komunitetit serb, ose rreth 2,3% e popullsisë së përgjithshme.¹⁴ Megjithatë, duke pasur parasysh se në katër komunat veriore u regjistruan drejtpërdrejt vetëm 3.080 persona që u deklaruan serbë, Agjencia e Statistikave të Kosovës përfshiu në rezultatet përfundimtare një vlerësim sipas të cilit në veri të Kosovës jetojnë 19.449 pjesëtarë të komunitetit serb.¹⁵

Në të njëjtën kohë, metodologjia mbi bazën e së cilës u bë ky vlerësim nuk është shpjeguar publikisht në masë të mjaftueshme. Nuk është e qartë se cilat burime të të dhënave, modele statistikore dhe kritere janë përdorur për vlerësimin e numrit të banorëve në katër komunat veriore, as në çfarë mase janë marrë parasysh regjistrat administrativë, vlerësimet e mëparshme apo burime të tjera të disponueshme. Kjo paqartësi metodologjike e vështirëson verifikimin e pavarur të besueshmërisë së vlerësimit dhe lë hapësirë për interpretime të ndryshme të rezultateve përfundimtare të regjistrimit.

Pavarësisht këtij korrigjimi, të dhënat për numrin e pjesëtarëve të komunitetit serb mbeten të paplota. Ato nuk përfshijnë një numër të madh personash të zhvendosur, shumica e të cilëve jetojnë në Serbinë qendrore. Sipas vlerësimeve të organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve të Republikës së Serbisë, më shumë se 200.000 persona të zhvendosur nga Kosova vazhdojnë të jetojnë në Serbi. Për këtë arsye, të dhënat e disponueshme nuk mund të konsiderohen tregues përfundimtar i numrit të përgjithshëm të komunitetit serb të lidhur me Kosovën, por rezultat i regjistrimit dhe i vlerësimeve të mëvonshme statistikore, të realizuara në rrethana specifike.

Edhe sikur të dhënat demografike të ishin të plota dhe të pakontestueshme, shtrirja e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të komuniteteve nuk varet nga numri i pjesëtarëve të tyre. Këto të drejta përbëjnë garanci kushtetuese që ushtrohen pavarësisht përqindjes së një komuniteti të caktuar në popullsinë e përgjithshme.

¹³ <https://minorityrights.org/communities/serbs-3/>

¹⁴ <https://kossev.info/srpska-lista-sr-bi-ucesce-popis-kosovo/>

¹⁵ https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sr/ASK-data/ASKdata__Census%20population__1_

Nga toponimi te identiteti i komunitetit

Në shoqëritë që karakterizohen nga diversiteti etnik dhe gjuhësor, emërtimet zyrtare gjeografike kanë rëndësi të madhe. Ato përbëjnë pjesë të dukshmërisë publike të komuniteteve, konfirmojnë praninë e tyre historike dhe pasqyrojnë parimin kushtetues të barazisë së gjuhëve.

Në praktikën ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të pakicave, e drejta për përdorimin e emërtimeve tradicionale të vendeve konsiderohet pjesë përbërëse e mbrojtjes së identitetit kulturor dhe gjuhësor.

Në këtë rast, ky parim ka peshë shtesë, duke qenë se përdorimi i barabartë i gjuhës shqipe dhe asaj serbe përbën një nga themelet e rendit kushtetues të vendosur pas shpalljes së pavarësisë.

Dygjuhësia nuk është vendosur si një kompromis politik me kohëzgjatje të kufizuar, por si një detyrim i përhershëm kushtetues, i cili duhet të kontribuojë në ndërtimin e besimit ndërmjet komuniteteve dhe në përfaqësimin e tyre të barabartë në jetën publike.

